



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ENINA B. JUNIKU
ADRESA NR.5, PERLAT REXHEPI,
NR.1, NR.1, NR.2
TEL: 692022261

REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 153

Nr. koleksioni: 95/1

Tirane më 02/11/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2022052490009894606



AKT - THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGTARE

"Te Khai" Sh.p.k.



Në Tiranë, sot më datën 02 (dy) Nëntor 2022 (dy mijë e njëzet e dy), ditën e mërkurë, përpara meje Noter **Enina B. JUNIKU**, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me seli në adresën: Bashkia Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 5, rruga "Perlat Rexhepi", ND. 1, H. 14, kati i II-të, Zyra Nr. 2, Kodi Postar 1019, Tiranë, u paraqit personalisht shtetasja:

Nikolina JEGENI, atësia Piro, amësia Alida, datëlindja 01.01.1992, vendlindja Vlorë, shtetase shqiptare, me status civil e martuar, me regjim pasuror "në bashkësi ligjore", banuese në adresën e vet deklaruar: Njësia Administrative Nr. 9 Tiranë, 1016, Bashkia Tiranë, rruga "Urani Pano", Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar nëpërmjet dokumentit Letërnjoftim me numër 037879117 dhe numër personal J25101104V, me datë lëshimi 21.10.2021 dhe datë skadimi 20.10.2031, autoritet lëshues MPB.

E cila me vullnetin e saj të lirë e të plotë, duke iu përbajtur Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përkatësisht neneve 42, 49, dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neneve 26, 28, 32, 35, 68, e vijues të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), si Ortake e Vetme themeluese e **Shoqërisë tregtare "Te Khai" Shpk**, sot më datë 02 (dy) Nëntor 2022 (dy mijë e njëzet e dy), duke patur zotësi të plotë juridike për të vepruar;

BIE DAKORD DHE VENDOS

për sa vijon:

Neni - 1 - FORMIMI I SHOQËRISË

Themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **Shoqëria "Te Khai" Shpk**.

Shoqëria tregtare "Te Khai" Shpk, fiton personalitet juridik, si person juridik i së drejtës shqiptare, të formës Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me regjistrimin e saj në regjistrin e tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me parashikimet e ligjore të neneve 26, 28, 32, 35 dhe 69 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).

Shoqëria tregtare "Te Khai" Shpk, do të veprojë në bazë të legjislationit shqiptar në fuqi, këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni - 2 - SELIA, HAPËSIRA NË INTERNET DHE ADRESA ELEKTRONIKE

Shoqëria e ka selinë ligjore të regjistruar në Tiranë, në adresën: Bashkia Kamëz, rruga "Havzi Nela", Bathore, Zona Kadastrale Nr.2066, Ndërtesë me Nr. Pasurie 209/92-ND, Tiranë.

Adresa e faqes zyrtare në internet e Shoqërisë tregtare "**Te Khai**" Shpk është www.tekhai.al. Adresa e shoqërisë për komunikim elektronik është info@tekhai.al.

Shoqëria mund të zhvillojë veprimtarinë e saj ekonomike në të gjithë territorin e Shqipërisë si edhe jashtë saj duke hapur degë dhe/ose zyra përfaqësimi, filiale, agjenci etj. në qendra të tjera administrative në përputhje me legjislationin e vendeve në të cilat ato hapen.

Neni - 3 - KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të fillojë me regjistrimin e saj juridik dhe fiskal në Regjistrin Tregtar, dhe do të vazhdojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

Shoqëria mund të prishet apo shpërbehet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga Orktaku i Vetëm i Shoqërisë.

Nikolina Jegeni



A2022052490009894606

Neni - 4 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Te Khai" Shpk, do të zhvillojë aktivitetin e saj tregtar me objektin e veprimtarisë, si më poshtë:

- Ushtrimi i aktivitetit tregtar privat, në fushën e arsimit parashkollor, nëpërmjet ngritjes, organizimit dhe funksionimit të çerdheve dhe kopshteve private, (me dhe pa ushqim), për fëmijët nga mosha 3 muaj deri në moshën 7 vjeç.
- Ushtrimi i aktivitetit privat në fushën e edukimit dhe arsimit parashkollor.
- Ofrim i shërbimeve ditore të kujdesit për foshnjat dhe fëmijët, me dhe pa ushqim.
- Ofrim i shërbimeve të organizimit të aktiviteteve të argëtimit të fëmijëve.
- Organizimi i kurseve dhe trajnimeve të ndryshme në fushën e edukimit.

Neni - 5 - KAPITALI I SHOQËRISË

- Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Te Khai" Shpk është 100,000 (njëqind mijë) Lek dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë, të zotëruar në masën 100% (njëqind për qind) nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe zotërohet nga **Ortaku i Vetëm i Shoqërisë zonja Nikolina Jegeni**, zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme 100,000 (njëqind mijë) Lek, që përbën 100% (njëqind për qind) të pjesëve të kapitalit themeltar të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Te Khai" Shpk.

Neni - 6 - TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuota e shoqërisë mund të transferohet tërësisht ose pjesërisht sipas procedurave të parashikura nga statuti i shoqërisë.

Neni - 7- ADMINISTRATORI/ËT

Shoqëria administrohet nga një ose me shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë për një afat sipas Nenit 81, paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 të Ligjit. Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi të zakonshëm i cili, nëse miratohet, çon në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator, në këtë detyrë për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi.

Shoqëria Tregtare "Te Khai" Shpk ka si Administrator të saj zonjën **Nkolina JEGENI**, atësia Piro, amësia Alida, datëlindja 01.01.1992, vendlindja Vlorë, shtetase shqiptare, mbajtëse e Letërnjoftimit me numër 037879117 dhe numër personal J25101104V, banuese në adresën Njësia Administrative Nr. 9 Tiranë, 1016, Bashkia Tiranë, rruga "Urani Pano", Tiranë, e cila do qëndrojë në këtë detyrë për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi.

Neni - 8 - VULA E SHOQËRISË

Shoqëria ka vulën e saj zyrtare me përmbajtjen:
Shoqëria Tregtare "Te Khai" Shpk

Neni - 9- BILANCI DHE TË ARDHURAT

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti.

Në mbylljen e çdo viti financiar, Administratori i Shoqërisë bën inventarin dhe llogaritë vjetore, në përputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton një raport me shkrim për administrimin.

Raporti i administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore të hartuara nga Administratori, i nënshtrohen miratimit me Vendim të Ortakut të Vetëm brenda një afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes të vitit financiar.

Neni - 10 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhenat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Ortaku i Vetëm mund t'i delegojë kompetencat e tij.



A2022052490009894606

Neni - 11 - SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Shpërbërja e Shoqërisë "Te Khai" Shpk mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak, duke vepruar sipas kritereve të parashikuara në Statutin e Shoqërisë.

Neni - 12 - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Për çdo çështje që nuk rregullohet nga ky Akt Themelimi i Shoqërisë tregtare "Te Khai" Shpk, do të zbatohen dispozitat përkatëse të fushës respektive të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni - 13 - HARTIMI I AKTIT TË THEMELIT

Ky Akt themelimi i shoqërisë tregtare përbëhet nga 3 (tre) fletë dhe mbyllet me 14 (katërmëdhjetë) nene. Me kërkesë të ortakut të vetëm themelues hartohet në 4 (katër) kopje të barasvlershme në gjuhën shqipe. Çdo njëra për tyre ka përmbajtje të njëjtë ligjore, nga të cilat kopja e parë që përmban pullën e tarifës mbahet nga noteria për arkivën noteriale dhe kopjet e tjera i dorëzohen Ortakut të Vetëm njëkohësisht Adminsitratore e Shoqërisë.

Adminsitratorja e Shoqërisë, merr dijëni mbi detyrimin ligjor për depozitimin për regjistrimin e shoqërisë si person juridik në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë "Te Khai" Shpk.

Adminsitratorja e Shoqërisë, merr dijëni mbi detyrimin ligjor për regjistrimin fillestar të të dhënave të pronarit përfitues i cili duhet të bëhet njëkohësisht me aplikimin për regjistrimin e personit juridik në regjistrin tregtar. Mospërmbushja e këtij detyrimi në përputhje me nenin 5 të Ligjit Nr. 112/2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues" (i ndryshuar), përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

Në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", unë Noteria deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akti noterial, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, përpunim dhe deklarim i cili i bëhet i ditur ortakut të vetëm themelues të shoqërisë nga unë noteria, duke u miratuar nga vetë ortaku themelues, kërkuese e shërbimit noterial.

Neni - 14 - NËNSHKRIMI

Detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga ky akti noterial i fillon efektet e tij nga momenti i nënshkrimit të këtij Akti Themelimi të shoqërisë tregtare.

Me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi, Ortaku i Vetëm themelues njëkohësisht Adminsitrator i Shoqërisë zonja Nikolina Jegeni, autorizon Zyrën Noteriale me Noter Enina B. Juniku, Dega Vendore Tiranë, që të kryejë të gjitha procedurat dhe veprimet e nevojshme ligjore, për depozitimin e akteve të krijimit të shoqërisë, nënshkrimin elektronik të dokumentacionit përkatës të aplikimit për regjistrimin e Shoqërisë "Te Khai" Shpk, në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë "Te Khai" Shpk, në sportelin elektronik të QKB-së, nëpërmjet autentifikimit nga portali unik i shërbimeve qeveritare "e-Albania".

Për sa më sipër, hartohet nga unë noterja ky Akti Themelimi i Shoqërisë Tregtare, në bazë të nenit 62 gërma "II", nenit 63, nenit 105 e vijues të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë" (i ndryshuar), e cila iu lexua me zë të lartë e të qartë të themelueses dhe themeluesja më deklaroi se e kuptoi plotësisht përmbajtjen e këtij Akti Themelimi dhe meqenëse gjendet konform vullnetit të saj të lirë dhe të plotë, nënshkruhet rregullisht prej saj në prezencën time, ndërsa Unë Noterja, e vërtetoj nënshkrimin e saj dhe këtë Akti Themelimi të shoqërisë tregtare sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Emri dhe Nënshkrimi i Themeluesit të :
Shoqërisë Tregtare "Te Khai" Shpk
Ortaku i Vetëm Themelues
Nicolina Jegeni

Nicolina Jegeni
[Signature]

NOTER
Enina B. JUNIKU

Enina B. Juniku
[Signature]